



Buxheti Rishikuar 2026

**Fushë Kosovë
Korrik 2026**

Përmbajtja

1.	Hyrje.....	2
2.	Buxheti operativ i ndërmarrjes	4
	2.1 Struktura e të hyrave	4
	2.2 Struktura e shpenzimeve	9
3	Përmbledhje ekzekutive	12

Hyrje

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës SH.A është krijuar në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/110 të datës 26.02.2010 mbi ndarjen e Hekurudhave të Kosovës SH.A në dy kompani të reja:

- **Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës SH.A „INFRAKOS”; dhe**
- **Operimin me Trena të Hekurudhave të Kosovës SH.A „TRAINKOS”**

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës SH.A - INFRAKOS si kompani veprimtarinë kryesore e ka ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës për operatorët transportues hekurudhor siç është NP Trainkos SH.A. dhe operator transportues hekurudhor privat. Infrakos SH.A, ka filluar të veprojë si kompani në vete që nga data 01.09.2011.

INFRAKOS SH.A si njëra ndër trashëgimtarët e Hekurudhave të Kosovës SH.A, në tërësi është një kompani publike në pronësi të shtetit dhe si e tillë shtrihet dhe vepron në territorin e Kosovës.

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës SH.A apo shkurtesa e kompanisë së re Infrakos SH.A e regjistruar në ARBK me Nr. Unik identifikues 811415620 që i menaxhon dhe mirëmban 333 km të linjave ekzistuese hekurudhore, 105 kilometra në stacione dhe mbi 100 kilometra linja industriale, sistemet e sinjalizimit, sistemet e komunikimeve, sistemet e energjetikës, 32 stacione hekurudhore, 115 ura me gjatësi prej 2988 metrash, 23 tunele me gjatësi prej 9020 metrash, 759 lëshesa dhe 257 vendkalime në nivel, si dhe ndërtesa tjera dhe pronën tokësore në tërë territorin e Kosovës siç shihet në hartë.



Përveç ofrimit të linjave hekurudhore në shërbim për operim dhe organizim të trafikut hekurudhor, biznesi i infrastrukturës hekurudhore ka të bëjë edhe me ndërtimin e binarëve industrial dhe infrastrukturës tjetër hekurudhore për nevoja të kompanive të ndryshme, si dhe dhënien me qira të pronës hekurudhore për përfitime komerciale.

Fushë veprimtarja kryesor e Infrakos SH.A është: Menaxhimi, mirëmbajtja, renovimi, përmirësimi dhe ndërtimi i infrastrukturës hekurudhore si; (linjave hekurudhore, stabilimenteve sinjal-sigurues, stabilimenteve tele-komunikues, stabilimenteve të energjetikës, objekteve të stacioneve dhe objekteve tjera); ofrimin e shërbimeve në терминалет e mallrave, menaxhimi, mirëmbajtja dhe dhënia në shfrytëzim e pronës dhe objekteve të infrastrukturës hekurudhore për përfitime komerciale, menaxhimin e trafikut hekurudhor nëpër të gjitha linjat hekurudhore të Kosovës dhe me pjesët e linjave të cilat e lidhin Kosovën me shtetet fqinjë, si dhe ofron të gjitha shërbimet tjera të nevojshme për të gjitha ndërmarrjet hekurudhore (operatorët me trena). Zakonisht buxhetit hartohet mbi bazën e analizave dhe krahasimeve të vijave buxhetore me perioda paraprake duke krahasuar me realizime apo mos realizime të objektivave. Për ta hartuar buxhetin është e domosdoshme që të bëjmë krahasime me realizimin e buxhetit në mënyrë që të eliminojmë ngecjet dhe të planifikojmë për periudhën e mbetur të vitit fiskal duke i harmonizuar parashikimet me mundësit dhe nevojat pra, harmonizimi i të hyrave në raport me shpenzimet. Buxheti për vitin 2026 i Infrakos SH.A është i bazuar në strategjinë e prezantuar në Planin e Biznesit të Infrakos SH.A për vitin 2026 e cila strategji është e mbështetur në deklaratën e vizionit dhe misionit të ndërmarrjes që janë:

Vizioni

Të jemi prijës në ofrimin e traseve hekurudhore dhe shërbimeve tjera të infrastrukturës për të gjithë operatorët e transportit hekurudhor brenda dhe jashtë vendit në mënyrë të barabartë, transparente dhe jo diskriminuese. Të jemi ofrues tërheqës dhe më i efektshëm i rrjetit hekurudhor në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Misioni

Krijimi i një rrjeti hekurudhor konkurrues, të qëndrueshëm dhe të suksesshëm në përputhje me nevojat e shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës dhe më gjerë, si dhe duke i plotësuar kërkesat e sigurisë, të ambientit dhe ato ekonomike.

Objektivat e biznesit të Infrakos SH.A bazohen në të dhënat historike, analizat e tregut, analiza e kapaciteteve teknike dhe analiza financiare. Këta faktorë janë analizuar mirë duke e pas parasysh ndikimin në realizimin e objektivave të paparapara me planin e biznesit, vendosjen e një bilanci në mes të hyrave dhe shpenzimeve dhe ruajtjen e likuiditetit të ndërmarrjes.

Menaxhmenti i NP "Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës" zbaton një politikë të kujdesshme dhe konservatore të menaxhimit financiar, të orientuar në kontrollin rigoroz të shpenzimeve, shmangien e krijimit të obligimeve pa mbulim financiar dhe ndjekjen e një qasjeje proaktive për rritjen e të hyrave vetanake. Përmes kësaj qasjeje synohet ruajtja e likuiditetit të ndërmarrjes, forcimi i qëndrueshmërisë financiare dhe krijimi i parakushteve për përmirësime dhe zhvillim të mëtejshëm të veprimtarisë së saj.

BUXHETI OPERATIV I NP INFRAKOS SH.A

Buxheti operativ i ndërmarrjes planifikohet të realizohet nga veprimtaria që zhvillon ndërmarrja dhe atë kryesisht në shfrytëzimin e linjave hekurudhore nga operatorët, dhënie me qira të pronës dhe ofrimi i shërbimeve në ndërtimin, riparimet si dhe mirëmbajtja e binarëve industrial. Për vitin 2026 me rishikim planifikohet realizimi i të hyrave të jetë **3,753,200.00€, që paraqet një reduktim në raport me planifikimin fillestar (3,878,200.00 €)** për 3%. Ky reduktim paraqitet për shkak të korrigjimit të kategorisë së të hyrave të shtyra të cilat janë rishikuar të jenë 710,000.00€ nga 840,000.00€ sa ishte planifikimi fillestar. Kjo kategori nuk ndikon në rezultatin operativ pasi të njëjtat paraqiten edhe në shpenzime të zhvlerësimit. dhe ndarjes prej me 35,000.00€ me pak se planifikimi fillestar (200,000.00) nga Ministria e Ekonomisë (ME).

Të hyrat, me buxhetin e rishikuar të vitit 2026, planifikohen 3,753,200, që krahasuar me vitin 2025 (3,322,153.00 €), janë më të larta për **13%** apo shprehur në vlerë prej 431.047.00 € më të larta.

Shpenzimet me buxhetin e rishikuar për vitin 2026 planifikohen në vlerë prej **3,485,866.00€** që në raport me planifikimet fillestare 2026 (3,752,893.00€), paraqet një projeksion në ulje të shpenzimeve për 7% apo -267.027.00€, ndërsa në raport me buxhet e rishikuar të 2025 (3,539,600.00€), paraqet një projeksion ulje prej 1.52% apo -53,734€.

Në bazë të planifikimeve raporti të hyra – shpenzime, pritet të rezultojnë me një rezultat financiar pozitiv prej 267,027.00€ (shprehur si dallim në 7%). Rezultati i planifikuar me buxhetin e fillestar 2026 ishte 125,307.00€.

Struktura të hyrave të ndërmarrjes

Të hyrat nga qasja në binar nga operatorët transportues hekurudhor

Të hyrat kryesore sipas veprimtarisë së biznesit të Infrakos-it me buxhetin për vitin 2026, parashihen të jetë nga shfrytëzimi i linjave hekurudhore nga operatori dhe atë në vlerë prej 174,000.00€ e që shprehur në përqindje do të jetë 2% me të larta se me buxhetin i rishikuar për vitin 2025.

Vlen të ceket se kalkulimet për këtë kategori të të hyrave janë bërë bazuar në tarifat e aprovuara nga MI-së, që ka diferenca me dokumentin e Ekspozesë së rrjetit të hartuar nga Infrakos SH.A, e cila diferencë me këtë buxhet është paraparë të mbulohet nga Qeveria e Kosovës përmes subvencionimit.

Realizimi i të hyrave nga transporti planifikohet të realizohet nga Trainkos SH.A dhe Railtrans të cilët janë klientët e vetëm që operojnë në këtë fushë.

Struktura e këtyre të hyrave që prite të realizohet është:

- *Të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit TM.....0.00€*
- *Të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit TU.....174,000.00€*

Të hyrat nga qiraja

Me buxhetin për vitin 2026, parashihen të realizohen **1,430.000.00€ (1,390,000.00€)**, (3% me të larta), ndërsa krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2025 (1,308,177.00€), janë më të larta për 13%.

Të hyrat nga shfrytëzimi i fibrave (kabullit) optik.

Të hyrat e realizuar nga kabulli optik në bazë të kontratës me PTK-në në vlerë prej 296,640.00€.

Të hyrat nga qiraja (prona)

Këto të hyra nga qiraja me buxhetin e vitit 2026 parashihet të realizohen në vlerë prej 1,133,360.00€. këto të hyrat janë kalkuluar në bazë të dhënave të sektorit të patundshmërisë e që janë mbështetur në mundësinë e dhënies me qira të objekteve sipërfaqes tokësore që Infrakos SH.A i menaxhon përgjatë linjave hekurudhore.

Të hyrat tjera

Të hyrat tjera do të jenë 174,200.00€ me buxhetin për vitin 2026, krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2025 janë më të larta për 7%.

Struktura e të hyrave tjera që priten të realizohen është:

- *Të hyrat shifja e mbeturinave*.....90,000.00€
- *Të hyrat tjera*.....84,200.00€

Subvencionet nga Buxheti i Kosovës

Subvencionet nga BK-së për viti 2026 janë paraparë në shumë prej 1,265.000.00€ (1,300,000.00€) nga Ministria e Ekonomisë.

Të hyrat e shtyra (grantet nga BK)

Të hyrat e shtyra janë kalkuluar në shumë prej 710,000.00€ (840,000.00€) , të hyra këto që nuk do ndikojnë në rezultat ngase tërë shuma trajtohet si shpenzime të zhvlerësimit.

Tabela 1: Të hyrat- buxheti për vitin 2026, krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2025 dhe realizimin e vitit 2025:

Nr	Përshkrimi	Buxheti i realizuar 2025	Buxheti i planifikuar 2026	Të hyrat e realizuara Janar – Qershor 2026	Të Hyrat e planifikuara Korrik – Dhjetor 2026	Të hyrat e planifikuara me rishikim 2026
			A	B	C	D
1	Të hyrat nga pagesat e qasjes në binarë	168,866.00	174,000.00	82,984.46	91,015.54	174,000.00
2	Të hyrat nga qiraja	1,380,089.00	1,390,000.00	766,262.66	663,733.34	1,430,000.00
3	Të hyrat tjera	109,531.00	174,200.00	101,240.19	72,959.81	174,200.00
4	Të hyrat e shtyra nga grante-BK	693,840.00	840,000.00	359,403.66	350,596.34	710,000.00
5	Subvencionimi nga Qeveria	975,000.00	1,300,000.00		1265,000.00	1,265,000.00
	Gjithsejtë të hyrat	3,327,326.00	3,878,200.00	1,309,890.97	2,443,305.03	3,753,200.00

Tabela 2: Shpenzimet e planifikuara në buxhetin e rishikuar për vitin 2026, krahasuar me buxhetin e realizuara në vitin 2025:

Nr.	Përshkrimi	Shpenzimet e planifikuara 2025	Shpenzimet e planifikuara 2026	Shpenzimet e planifikuara me RISHIKIM 2026	Diferenca
		A	B	C	
1	Pajisjet	27,788.00	15,510.00	20,900.00	5,390.00
2	Harxhimet në lokale (ndërtesa)	34,344.00	74,000.00	44,500.00	-29,500.00
3	Energjia elektrike	68,375.00	154,000.00	168,000.00	14,000.00
4	Nafta	19,088.00	24,900.00	37,647.00	12,747.00
5	Vajrat, lubrifikantët etj.	1,895.00	3,850.00	3,850.00	0.00
6	Materiali harxhues operativ	82,893.00	111,460.00	108,160.00	-3,300.00
7	Riparimet	13,588.00	105,500.00	92,000.00	-13,500.00
8	Shërbimet operative	2,550.00	4,000.00	4,000.00	0.00
9	Udhëtimet zyrtare	9,438.00	9,025.00	9,025.00	0.00
10	Marketingu dhe publikimet	1,120.00	5,300.00	5,300.00	0.00
11	Shkollim/Trajnime	2,069.00	2,500.00	2,500.00	0.00
12	Materiali i zyrës dhe konsumues	8,769.00	28,400.00	32,150.00	3,750.00
12	Telefoni, posta dhe interneti	8,075.00	11,490.00	12,330.00	840.00
13	Shpenzimet e rrezikshmësie	75,963.00	158,000.00	178,000.00	20,000.00
14	Shpenzimet e reprezent.,konsumuese	6,826.00	5,040.00	5,040.00	0.00
15	Sigurimi	78,720.00	98,552.00	78,000.00	-20,552.00
16	Stafi i jashtëm	2,500.00	3,000.00	3,000.00	0.00
17	Stafi dhe punëtorët	1,923,703.00	1,860,468.00	1,908,768.00	48,300.00
19	Shpenzime tjera operative	35,807.00	110,500.00	75,298.00	-35,202.00
20	Shpenzimet e zhvlerësimit	750,429.00	960,000.00	690,000.00	-270,000.00
21	Shpenzimet e interesit të kredisë	10,812.00	7,398.00	7,398.00	0.00
Gjithsejtë shpenzimet		3,164,752.00	3,752,893.00	3,483,868.00	-268,025.00

Tabela 3: Rezultatit financiar- buxheti për vitit 2026, të krahasuara me buxhetin e rishikuar të vitit 2025 dhe realizimin për vitin 2025:

Nr.	Përshkrimi	Realizimi 2026 (realizimi Janar- Qershor)	Buxheti i planifikuar 2026	Buxheti I REVIDUARY 2026	Diferenca
		A	B	C	B-C
1	Gjithsejtë të hyrat		3,878,200.00	3,753,200.00	125,000.00
2	Gjithsejtë shpenzimet		3,752,893.00	3,567,098.00	185,795.00
Rezultati Netë			125,307.00	287,022.00	

Nga të hyrat e parashikuara me buxheti zbriten shpenzimet e parashikuara shohim se do të kemi një rezultat pozitiv /fitim prej **267,027.00€**

BUXHETI OPERATIV SIPAS DEPARTAMENTEVE TË INFRAKOS SH.A. PËR VITIN 2026

përshkrimi	Buxheti i planifikuar 2026 me revidim	Bordi&Kabineti i KE (Prokurim, MPM, IT)	Dep.DSHK	Dep.Infra	Dep.i Fin.
Të hyrat nga pagesat e qasjes në binarë	174,000.00	-	-	174,000.00	-
Të hyrat nga qiraja	1,430,000.00	-	1,430,000.00	-	-
Të hyrat tjera	174,200.00	-	-	174,200.00	-
Të hyrat e shtyra	710,000.00	-	-	690,000.00	-
Subvencionimi nga Qeveria	1,265,000.00	-	1,100,000.00	165,000.00	-
	3,753,200.00	-	2,530,000.00	1,203,200.00	-
Përshkrimi	Shpenzimet e planifikuara 2026 me revidim	Bordi&Kabineti i KE (Prokurim, MPM, IT)	Dep.DSHK	Dep.Infra	Dep.i Fin.
Pajisjet	20,900.00	200	6,600.00	8,900.00	5200
Hargj.e.lok. (ndertesave)	44,500.00	-	28,600.00	10,900.00	5000
Ënergjia Elektrike	168,000.00	-	-	168,000.00	-
Nafta	37,647.00	-	-	37,647.00	-
Vajrat, lysterësit etj.	3,850.00	-	-	3,850.00	-
Materiali/hargj.operat.	108,160.00	-	5,200.00	102,960.00	-
Riparimet	92,000.00	-	7,500.00	84,500.00	-
Shërbimet Operative	4,000.00	-	4,000.00	-	-
Udhëtimet zyrtare	9,025.00	8,785.00	240	-	-
Markez. dhe Publikimet	5,300.00	2,000.00	3,300.00	-	-
Shkollimi/Trajnim	2,500.00	-	2,500.00	-	-
Mat. i Zyrës dhe Konsum.	32,150.00	18,500.00	9,850.00	3,800.00	-
Telefoni dhe Mail/Internet	12,330.00	1,660.00	1,250.00	1,620.00	7,800.00
Shpenzimet e rrezikshmërisë	178,000.00	-	178,000.00	-	-
Reprezentacion/konsumuese	5,040.00	3,600.00	480	480	480
Sigurimi	78,000.00	-	71,000.00	7,000.00	-
Stafi i jashtëm	3,000.00	-	3,000.00	-	-
Stafi dhe Punëtorët	1,990,000.00	-	1,908,768.00	-	-
Shpenzimet tjera operative	75,298.00	-	18,298.00	-	57,000.00
	2,788,468.00	34,745.00	2,918.00	429,657.00	75,480.00
Zhvlerësimi	690,000.00				
Shp.Financiare	7,398.00				
Taksat	-				
Total shpenzim	3,485,098.00				
REZULTATI NETO	267,334.00				

STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË NDËRMARRJES

Shpenzimet e Infrakos SH.A. të planifikuara me buxhetin e vitit 2026 arrijnë shumën prej 3,752,893.00€, krahasuar me buxhetin e rishikuar të vitit 2025, parashihen që shpenzimet të jenë më të larta për 6% apo shprehur në vlerë prej 213,293.00€ .

Nga shpenzimet e përgjithshme të parapara me buxhetit për vitin 2026 me pjesëmarrjen më të madhe janë pagat dhe kompensimet e punëtorëve, ku përfshihen të gjitha shpenzimet si pagat e punëtorëve, pensionimi stafit, stafi për PIU dhe kompensime tjera që ndërlidhen me marrëdhënien e punë në shumë prej 1,860,468.00€.

Klasifikimi i shpenzimeve të planifikuara sipas pjesëmarrjes së përqindjes në shpenzimet e përgjithshme për vitin 2026 është me sa vijon:

Nr.	Përshkrimi	Shpenzimet e planifikuara me RISHIKIM 2026	
		B	Shprehur si %
1	Pajisjet	20,900.00	0.60%
2	Harxhimet në lokale (ndërtesa)	44,500.00	1.28%
3	Energjia elektrike	168,000.00	4.82%
4	Nafta	37,647.00	1.08%
5	Vajrat, lubrifikantët etj.	3,850.00	0.11%
6	Materiali harxhues operativ	108,160.00	3.10%
7	Riparimet	92,000.00	2.64%
8	Shërbimet operative	4,000.00	0.11%
9	Udhëimet zyrtare	9,025.00	0.26%
10	Marketingu dhe publikimet	5,300.00	0.15%
11	Shkollim/Trajnime	2,500.00	0.07%
12	Materiali i zyrës dhe konsumues	32,150.00	0.92%
12	Telefoni, posta dhe interneti	12,330.00	0.35%
13	Shpenzimet e rrezikshmërisë	178,000.00	5.11%
14	Shpenzimet e reprezent.,konsumuese	5,040.00	0.14%
15	Sigurimi	78,000.00	2.24%
16	Stafi i jashtëm	3,000.00	0.09%
17	Stafi dhe punëtorët	1,908,768.00	54.76%
19	Shpenzime tjera operative	75,298.00	2.16%
20	Shpenzimet e zhvlerësimit	690,000.00	19.79%
21	Shpenzimet e interesit të kredisë	7,398.00	0.21%
Gjithsej shpenzimet		3,485,866.00	100%

Shpenzimet totale të ndërmarrjes planifikohen të jenë 3,567,098€, të cilat janë të sqaruara në kategoritë buxhetore si në vijim:

Pajisjet, mirëmbajtja dhe pjesët rezerve:

Shpenzimet për këtë kategori me buxhetin e vitit 2026 parashihen të janë 20,900.00€, krahasuar me buxhetin e rishikuar të vitit 2025 (40,078) janë për 48% më të ulëta.

Parashikimet sipas departamenteve janë:

- Departamenti teknik dhe i komunikacionit: ka parashikuar shumën prej 8.900€, si në vijim: piseje elektrike 500.00€ pajisjet radio/signal/com 200.00€; pajisjet tjera infra.2,000.00€; pajisje për zyrë në vlerë prej 200.00€; pajisje tjera 3000.00€ dhe pajisjet për vegla pune 5000.00€.
- Departamenti i shërbimeve të korporatës: ka parashikuar shumën prej 6,600.00€ , si në vijim; pajisje për zyre 1910.00€; pajisje tjera 290.00 €; pajisje për punëtor 1,500.00€; pajisje për pastrim 1,900.00€; pajisje për vegla pune 1900€.
- Departamenti i financave; pajisje për zyre janë parashikuar me shumë prej 200.00€, si në vijim; pajisje/inventar për zyre për staf (tavolina dhe kërriga etj) dhe shumën prej 5,000.00€ për fillim te procedurave (hartim te specifikave) për softwer financiar.
- Bordi & Kabineti i KE; zyra për marrëdhënie me publikun ka parashikuar shumen prej 200.00€ dhe atë: pajisje për zyre në vlerë prej 100.00€ për staf (tavolina dhe kërriga etj.) dhe pajisje tjera në shumën prej 100.00€.

Harxhimet e lokaleve (ndërtesave):

Shpenzimet për këtë kategori me buxhetin e vitit 2026 parashihen të janë 44,500.00€, krahasuar me buxhetin e rishikuar të vitit 2025 (42,237) janë për 5% më të larta.

- Departamenti teknik dhe i komunikacionit; ka paraparë shumën prej 10,900.00€ për këtë kategori të shpenzimeve të tjera 8500€ (pjesë për infrastrukturë) dhe shpenzime e qirasë 2,400.00€.
- Departamenti i shërbimeve të korporatës: ka paraparë shumën prej 28,600.00€ për këtë kategori të shpenzimeve, si në vijim: shpenzimet për mbeturin 2,500.00€; riparimi i sistemit të ngrohjes 3,000.00€; thëngjill për nxehtë 10,000.00€; sh.kanalizim 1,000.00€; material për sistem të ujit 2,000.00€; konsumimi i ujit 3,100.00€ dhe riparimi i objekteve në vlerë prej 7,000.00€ .
- Departamenti Financave ka parashikuar vlerën prej 5,000.00€, për inicim te procedurave (hartim te specifikave) për vlerësimin e pasurisë se ndërmarrjes.

Energjia elektrike:

Kjo kategori e shpenzimeve me buxhetin e rishikuar për vitin 2026 është parashikuar shuma prej 168,000.00€ , ku krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2025 (86,901.00€) janë më të larta për 85% si pasojë rritjes se çmimit. Parashikimet janë bërë nga departamenti teknik dhe i komunikacionit, kryesisht për shpenzime të rrymës në rrjetin elektrik në stacione dhe linjat hekurudhore.

Nafta:

Me buxhetin e vitit 2026 shpenzimet e derivateve janë parashikuar me shumën prej 37,646.00€ kryesisht për makineritë hekurudhore dhe veturat e terenit.. Në raport me vitin 2025 (28,506) paraqet një rritje prej 32%, si pasojë e rritjes se çmimit. Parashikimet janë bërë në tersi nga departamenti teknik dhe i komunikacionit.

Vajrat dhe lubrifikantet:

Me buxhetin e vitit 2026 shpenzimet për këtë kategori janë parashikuar me shumën prej 3,850.00€. Në raport me 2025 (1,106) [araqet një rritje prej 248%. Kjo për faktin se vitin e kaluar ka pasur rezerva te mëhershme. Parashikimet janë bërë në tersi nga departamenti teknik dhe i komunikacionit për nevojat te makinerive hekurudhore.

Materiali harxhues operativ:

Me buxhetin e vitit 2026 shpenzimet për këtë kategori janë parashikuar me shumën prej **108,160.00€**, krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2025 (154,571), janë më të ulëta për **30%**.

Parashikimet sipas departamenteve janë:

- Departamenti teknik dhe i komunikacionit; i cili ka planifikuar 102,960.00€, që do të shpenzohen si ma poshtë; materiali elektrik 1,000.00€; materiali për pastrim 960.00€; material për binarë 100,000.00€ (ME) dhe material tjera 1,000.00€.
- Departamenti i shërbimeve të korporatës ; ka planifikuar shumën prej 5,200.00€ për këtë kategori të shpenzimeve dhe atë; material për pastrim 4,000.00€ dhe material medicinat 1,200.00€.

Riparimet:

Me buxhetin e vitit 2026 për riparime është planifikuar shuma prej **92,000.00€**, ku krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2025 (47,190) janë më të larta për 95% . Janë me të larta pasi këtë vit ne kategori kemi 73,500.00€ që financohen nga ME.

Parashikimet sipas departamenteve janë:

- Departamenti teknik dhe i komunikacionit; ka planifikuar këto shpenzime në shumë prej 84,500.00€ dhe atë si ne vijim; riparim i binarëve 6,000.00€; riparim makinave për binar 73,500.00€ (financohet nga ME); riparimi i SS dhe TK 4,000.00€; dhe riparimet tjera 1,000.00€.
- Departamenti i shërbimeve të korporatës; ka planifikuar këto shpenzime në shumën prej 7,500.00€ dhe atë si ne vijim; riparimin dhe mirëmbajtjen e veturave në shumë prej 6,000.00€: servisimi i DDD. shuma prej 1,000.00€ dhe riparime tjera 500.00€.

Shpenzimet Operative:

Me buxhetin e vitit 2026 shpenzimet për këtë kategori janë planifikuar me shumën prej 4,000.00€, (transporti thëngjillit për ngrohje me kamion) ku krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2025 (3,506) janë më të apo ma të larta për 15% Parashikimi është bërë nga departamenti i shërbimeve të korporatës për transportimin me kamion të thëngjillit

Udhëtimet Zyrtare

Me buxhetin e vitit 2026 shpenzimet për këtë kategori janë planifikuar me shumën prej 9,025.00€ €, ku krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2025 (11,859) **janë më të ulëta për 23%**, ndërsa parashikimi është bërë për Bordi & Kabineti i KE; me buxhetin e vitit 2026 është parashikuar shuma prej 8,785.00 € për shpenzimet si në vijim: të hotelit, për udhëtime lokale, udhëtime me aeroplan, udhëtimet ndërkombëtare (jo me aeroplan),mëditje për udhëtime zyrtare dhe te tjera.

Marketingu dhe Publikimet

Me buxhetin e vitit 2026 shpenzimet për këtë kategori janë planifikuar me shumën prej 5,300.00€, ku krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2025 janë më të larta për 23%. Ndërsa sipas departamenteve është:

- Departamenti i shërbimeve të korporatës; parashihen 3,300.00€ nga parashikimet janë si: publikimet në shtypin ditor për konkurse etj. 1,000.00€; tjera 1,300.00€ dhe dhënie 1,000.00€.
- Bordi & Kabineti i KE ; zyra për marrëdhënie me publikun parashihen shumën 2,000.00€ dhe atë sinë vijim : publikimet 1,500.00€ dhe shtypi i reklamave 500.00€.

Shkollim/Trajnim:

Me buxhetin e vitit 2026 shpenzimet për këtë kategori departamenti i shërbimeve të korporatës ka planifikuar shumën prej 2,500.00€. Në raport me vitin 2025(3,794), paraqet ulje për **34%**.

Material i zyrës dhe konsumues:

Me buxhetin e vitit 2026 shpenzimet për këtë kategori janë planifikuar me shumën prej **32,150.00€**, ku krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2025 janë më të larta për 56%. Kjo për faktin së në fushën IT-

së është planifikuar mirëmbajtja e serverëve, fotokopjeve dhe licencave. Ndarja sipas departamenteve është si ma poshtë:

- Departamenti teknik dhe i komunikacionit ka parashikuar shumën prej 3,800.00€, dhe atë si në vijim; shpenzimet për shtypje 800.00€ dhe shpenzimet për licencë 3,000.00€.
- Departamenti i shërbimeve të korporatës ka parashikuar shumën prej 9,850.00€ €, dhe atë si në vijim: material për zyre 6,000.00 €; konsumueset për kompjuterë 350.00€; shpenzimet për shtypje 2,500.00€, artikuj të ndryshëm për zyre 500.00€; shpenzimet te tjera 500.00€.
- IT; parasheh 18,500.00€ dhe atë: 12,500.00€,(mirëmbajtjes serverëve dhe fotokopjeve); konsumueset për kompjuterë 500.00€; pajiset kompjuterike 500.00€; shpenzimet për licenca 5,000.00€.

Telefonia, posta dhe internet:

Me buxhetin e vitit 2026 shpenzimet për këtë kategori janë planifikuar me shumën prej 12,330.00€, ku krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2025 janë më të larta për 21%,, për shkak të kostos me të lart të internetit me operatorin publik. Ndërsa shpërndarja sipas departamenteve është:

- Departamenti Teknik dhe i Komunikacionit ka parashikuar shumën prej 1,620.00€, dhe atë e tërë shumën për shpenzimet e telefonisë fikse.
- Departamenti i shërbimeve të korporatës ka parashikuar shumën prej 1,250.00€ dhe atë e tërë shumën për shpenzimet e posta dhe dërgesave.
- Departamenti i financave ka parashikuar shumën prej 7,800.00€ dhe atë e tërë shumën për shpenzimet e telefonisë mobile-mbushje.
- IT, ka parashikuar shumën prej 1,660.00€ dhe atë e tërë shumën për shpenzimet e shërbimeve të internetit.

Shpenzimet e jashtëzakonshme / rrezikshmërisë:

Me buxhetin e vitit 2026 për këtë kategori janë planifikuar me shumën prej 178,000.00€ nga departamenti i shërbimeve të korporatës, ku sipas parashikimeve buxhetore këto shpenzime janë më të larta për 127% krahasuar me buxhetin e rishikuar 2025 (78,264) dhe atë si në vijmë: pagesa taksave gjyqësore prej 8,000.00€ dhe shpenzimet për kompensimi sipas aktgjyqësive gjyqësore në shumë prej 170,000.00€. Kjo rritje parashihet për të mbuluar detyrimet e pashlyera për projekte kapitale që nuk janë financuar nga ME gjatë vitit 2025.

Shpenzimet konsumuese:

Me buxhetin e vitit 2026 për këtë kategori janë planifikuar me shumën prej 5,040.00€ , ku sipas parashikimeve buxhetore këto shpenzime janë më të ulëta për 37% krahasuar me buxhetin e rishikuar 2025.

Sigurimi:

Me buxhetin e vitit 2026 për këtë kategori janë planifikuar me shumën prej 78,000€ të planifikuara për sigurim shëndetësor, sigurimi palëve të treta dhe vlerësim të riskut për vendet e punës. Në krahasim me 2025 (95,044) paraqet ulje prej 18%.

- Nga kjo kategori departamenti teknik dhe i komunikacionit ka paraparë shumën prej 7,000.00€ dhe atë; për sigurim të palëve të treta.
- Departamenti i shërbimeve të korporatës ka paraparë shumën prej 71,000.00€, dhe atë si në vijim; sigurim të veturave zyrtare në vlerë prej 3,500.00€; sigurimi shëndetësor 62,000.00€ dhe shpenzime mjekësore 1,000.00€, tjera – vlerësimi të riskut nga vendet e punës 4,500.00€.

Stafi i jashtëm / konsulentë:

Kjo kategori e shpenzimeve me buxhetin e vitit 2026, është planifikuar me shumën prej 3,000.00€ ,ku krahasuar me buxhetin e rishikuar të vitit 2025 (3850) janë më të ulëta për 22%. Parashikuar janë bërë nga departamenti i shërbimeve të korporatës për përkthyes dhe konsulent të jashtëm .

Shpenzimet e personelit-stafit:

Kjo kategori e shpenzimeve me buxhetin e rishikuar për vitin 2026 është planifikuar me shumën prej 1,908,768.00€, që paraqet një ngritje prej 48,300.00€ apo 2.60% në raport me planifikimet fillestare prej 1,860,468.00€, ndërsa në raport me buxhetin e planifikuar për 2025 (1,964,729.00€), paraqet një ulje prej 2.85%.. Në këtë kategori të shpenzimeve përfshihen të gjitha shpenzimet si pagat e punëtorëve, pensionimi stafit, stafi për PIU dhe kompensime tjera që ndërlidhen me marrëdhënien e punës. Në pjesën e dytë 2026 përveç punësimeve të zyrtareve të lartë planifikohen edhe disa punësime të kufizuara si në financa, burime njerëzore dhe eventualisht ndonjë inxhinier nga fusha ndërtimtarisë. Punësime tjera mund të ketë vetëm për të mbuluar pensionimet gjatë këtij viti.

Shpenzimet tjetra operative:

Kjo kategori e shpenzimeve me buxhetin e vitit 2026 është parashikuar me shumën 75,298.00€, ku sipas parashikimeve buxhetore këto shpenzime janë më të ulëta për 45% krahasuar me buxhetin të rishikuar 2025 (137,565), të shpërndara sipas departamenteve në:

- Departamenti i shërbimeve të korporatës ka parashikuar shumën prej 18,298.00€ për dhe atësi në vijim: shpenzime komunale 17,298.00€ dhe 1,000.00 për raste të jashtëzakonshme.
- Departamenti i financave ka parashikuar shumën prej 57,000.00€ dhe atë si në vijim: shpenzime për provizionin e borxheve të këqija 45,000.00€ dhe auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2026 dhe 2027 në vlerë prej 12,000.00€.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

NP Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS Sh.A. ka hartuar dhe aprovuar Buxhetin për vitin 2026, duke u bazuar në Planin e Biznesit për vitin 2026 dhe në rrethanat aktuale ekonomike e financiare që ndikojnë në veprimtarinë e ndërmarrjes. Duke marrë parasysh, në veçanti, vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me pagën minimale, është bërë i nevojshëm rishikimi dhe harmonizimi i Planit të Biznesit dhe Buxhetit për vitin 2026, me qëllim reflektimin e ndikimeve financiare dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së operimit të ndërmarrjes.

Përmes rishikimeve buxhetore është synuar krijimi i një balance ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara, si dhe ruajtja e likuiditetit financiar të ndërmarrjes, në rast të mosparaqitjes së rrethanave të paparashikuara apo faktorëve të jashtëm që nuk kanë qenë të njohur në momentin e hartimit të këtij buxheti.

Nga analiza e projeksioneve financiare rezulton se për vitin 2026 planifikohet realizimi i të hyrave në shumën prej 3,753,200.00 €, me një rritje prej 13% krahasuar me Buxhetin e Rishikuar të vitit 2025. Ndërsa, shpenzimet e planifikuara për vitin 2026 arrijnë shumën prej 3,567,098.00 €, me një rritje prej 0.78% krahasuar me Buxhetin e Rishikuar të vitit 2025.

Këto planifikime pritet të rezultojnë me një rezultat financiar pozitiv në vlerë prej 186,102.00 €. Buxheti i Rishikuar për vitin 2026 paraqet një planifikim të qëndrueshëm financiar, të bazuar në politika të kujdesshme të shpenzimeve, ruajtjen e likuiditetit dhe sigurimin e një performance pozitive financiare, duke krijuar bazë të qëndrueshme për zhvillimin e mëtejshëm të ndërmarrjes.

Aprovuar nga Bordi i Drejtoreve të NP. Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS SH.A me datë 30/07.2026.